



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 826/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shpresa (Azemi) Shemsedini kandidate për asamble komunale nga radhët e subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionerit Ardit Hajredini Komuna e Ferizajit, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Shpresa (Azemi) Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 12.11.2013, nga Shpresa (Azemi) Shemsedini për arsye të manipulimit të votave mbrenda subjektit politik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së parshihet se “ Mund të apelohej vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.

Pretendimet ankimore nga Shpresa (Azemi) Shemsedini kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik PDK –së, dega në Ferizaj se janë bërë shkeljet e theksuara, janë të pabazuara, nga shkaku se nuk janë bashkangjitur asnjë provë shtesë apo dëshmi bindesë ankesës së parashtruar me të cilat do të administrohej lënda, ose do të mund të vërtetohej vërtetësia e shkeljes së pretenduar.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 826/2013 më datën 12.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mërzënda njëzetekatër (orë)orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

